

Pranë fakulteteve të UK-së mund të krijohen qendra kërkimore-shkencore, si njësi bazë që kryejnë veprimtari kërkimore-shkencore dhe zhvillimi.

Qendra kërkimore-shkencore përbëhet nga jo më pak se 7 anëtarë, nëse do të jetë pjesë e strukturës së njësisë kryesore për plotësimin e standardeve të kësaj njësie. Drejtori i qendrës zgjidhet me shumicën e votave të asamblesë së anëtarëve të punësuar me kohë të plotë.

Qendra kërkimore-shkencore ka këto kompetenca:

- a) harton programet e kërkimit shkencor dhe i propozon për miratim në Senatin Akademik;
- b) miraton programin e kërkimit shkencor të anëtarëve të qendrës;
- c) miraton raportin vjetor të vlerësimit të brendshëm të qendrës kërkimore-shkencore për çdo vit akademik;
- d) miraton raportin vjetor të veprimtarisë mësimore dhe shkencore të qendrës kërkimore-shkencore;
- e) miraton rregulloren e qendrës kërkimore-shkencore.

Në ushtrim të funksioneve të veta qendra kërkimore-shkencore shprehet me vendime.

Qendra kërkimore-shkencore (QKSh-ja) e fakultetit ose e institutit është njësi bazë që kryen veprimtari kërkimore-shkencore dhe zhvillimi dhe kryen këto funksione:

- a) është përgjegjëse për zgjedhjen e fushave kërkimore-shkencore të saj ose të secilit grup kërkimor në përbërje, kjo në përputhje me misionin përkatës;
- b) është përgjegjëse për saktësimin, zgjerimin dhe thellimin e fushave kërkimore-shkencore, për mbulimin e tyre me stafin përkatës në përbërje, për kualifikimin në vazhdim të tij;
- c) mund të mbështetë realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” dhe “Doktoraturë”, të ofruara nga departamentet e fakultetit përkatës, ose nga departamente të fakulteteve të tjera;
- d) organizon aktivitete shkencore, mësimore, edukuese, ndërgjegjësuese kombëtare dhe ndërkombëtare;
- dh) është përgjegjëse për krijimin e hapësirave për zhvillimin e veprimtarive kërkimore-shkencore, mësimore, edukuese, ndërgjegjësuese etj.

QKSh-ja, nëse do të jetë pjesë e strukturës së njësisë kryesore për plotësimin e standardeve të kësaj njësie, duhet të përbëhet nga të paktën 7 anëtarë, nga të cilët, të paktën 3 të jenë me grada shkencore ose tituj. Drejtuesi zgjidhet sipas rregullave të zgjedhjes së drejtuesit të njësisë bazë.

Në rast se QKSh-ja nuk do të llogaritet si pjesë e strukturës së njësisë kryesore për plotësimin e standardeve, atëherë ajo mund të ketë në përbërjen e saj të paktën 3 anëtarë, nga të cilët njëri prej tyre duhet të ketë titull akademik. Përgjegjësi i qendrës zgjidhet në përputhje me kriteret e përcaktuara për drejtuesit e departamentit.

Qendra kërkimore-shkencore mund të ketë në përbërje edhe personel ndihmës akademik dhe administrativ.